

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Përkufizimi dhe Ndjekja e Veprës Penale  
të  
Trafikimit me Njerëz**

**Tetor, 2011**

*Mohim përgjegjësie:*

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) gjen se trafikimi me njerëz (prej këtu e tutje trafikim) mbetet një shqetësim serioz për të drejtat e njeriut pasi që sistemi gjyqësor në Kosovë shpesh nuk zbaton siç duhet kornizën ligjore që rregullon veprën e trafikimit.

Raporti shqyrton tre shembuj të këtij keq-zbatimi të ligjit të cilat identifikohen në mënyrë rutinore nga ana e monitoruesve të OSBE-së. Këto përfshijnë ngritjen e aktakuzave për trafikim kur elementet përkatëse të veprës së trafikimit nuk janë të pranishme. Një çështje e dytë e vërejtur është dështimi për të ndjekur trafikantët për veprimtari penale shtesë që është kryer gjatë rrjedhës së veprës së veçantë të trafikimit. Përfundimisht, duket se incidentet e trafikimit shpesh karakterizohen si vepër shumë më pak serioze se sa ajo e trafikimit, që rezulton me dënime më të lehta për kryesit.

Dështimi për ta zbatuar në mënyrë të duhur ligjin përkatës pengon gjykatat në Kosovë që t'i përgjigjen në mënyrë adekuate veprës penale të trafikimit. Analiza dhe zbatimi korrekt i ligjit nga akterët ligjor do të rris gjasat që mos-ndëshkimi për trafikantët të përfundojë dhe të zvogëlohet numri i viktimave të reja të trafikimit.

Me këtë qëllim, OSBE rekomandon që gjyqtarët dhe prokurorët të specifikojnë dëshminë që lidhet me secilin element të definicionit të trafikimit dhe në aktakuza të përfshijnë çfarëdo vepra tjera penale që janë kryer me veprën e trafikimit. OSBE po ashtu rekomandon që Instituti Gjyqësor i Kosovës të mbajë trajnime mbi definicionin e trafikimit, duke theksuar në veçanti dallimin ndërmjet trafikimit të një viktime të rritur dhe viktimës fëmijë.

## 2. HYRJE

Trafikimi mbetet një shqetësim tejet i madh për të drejtat e njeriut në Kosovë.<sup>1</sup> Sipas raportit më të fundit të Zyrës së Prokurorit të Kosovës, në vitin 2010, 125 persona ishin të dyshuar për trafikim me njerëz.<sup>2</sup> Përkundër përpjekjeve të kamotshme dhe të vazhdueshme për të parandaluar trafikimin,<sup>3</sup> OSBE ka vërejtur

<sup>1</sup> Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, *Raporti për Trafikimin me Njerëz (TIP) 2010* thotë se "Kosova është shtet i origjinës, transitit dhe destinacionit për gra dhe fëmijë që janë objekt trafikimi me njerëz, veçanërisht prostitucion të dhunshëm dhe për fëmijët kërkim lëmoshe me dhunë". <http://www.state.gov/documents/organization/143187.pdf>. (e qasur me 10 gusht 2011), fq. 20.

<sup>2</sup> Zyra për Statistika dhe Analiza e Zyrës së Prokurorit të Kosovës, *Raport Vjetor mbi Punën e Prokurorive të Kosovës*, 2010 (mars 2011), fq. 37.

<sup>3</sup> Raport i OSBE-së, *Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale* (tetor 2001). <http://www.osce.org/kosovo/13046> (e qasur me 28 prill 2011); raport i OSBE-së, *Analiza ligjore e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë* (tetor 2007), <http://www.osce.org/sq/kosovo/28416> (e qasur me 10 gusht 2011); raport i OSBE-së, *Vlerësimi për Themelimin e Mekanizmi Referues për Viktimat e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë* (tetor 2007), e disponueshme vetëm në gjuhën angleze në <http://www.osce.org/kosovo/28468> (e qasur me 10 gusht 2011); Raporti Vjetor për vitin 2008 i Përfaqësuesit Special dhe Koordinatorit për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore pranë Mbledhjes së Këshillit të Përhershëm, 13 nëntor 2008, *Përpjekjet për të Luftuar Trafikimin me Qenie Njerëzore në Terren të OSBE-së: Koordinimi dhe Mekanizmat për Raportim*, e

se praktikuesit e ligjit ne Kosovë shpesh dështojnë të zbatojnë ligjin sipër fakteve të gjetura në rastet potenciale të trafikimit.

Raporti bazohet në shqyrtimin e rasteve të ndërlidhura me trafikim pranë gjykatave të Kosovës që nga raporti i mëhershëm të OSBE-së, që analizonte rastet e trafikimit, i publikuar në vitin 2007.<sup>4</sup> Shqyrtimi i rasteve të trafikimit që nga viti 2007 vërtetoi se shumë shqetësime të dhëna në raportin e vitit 2007 qëndrojnë edhe sot, përfshirë shqetësimin parësor që diskutohet në këtë raport: akteret ligjor nuk zbatojnë siç duhet ligjin sipër fakteve dhe atë se si kjo pengon ndjekjen efektive penale të trafikimit.

Përkufizimi i veprës penale është analizuar në kuptim të tri elementeve të saj kryesore: veprës, mjeteve të paligjshme dhe qëllimit të shfrytëzimit. Një vendim gjyqësor mirë i arsytuar që lidh gjetjet faktike me ligjin përkatës është dhënë si shembull i praktikës më të mirë. Theksi në sqarimin e definicionit të trafikimit në këtë raport është në përgjigje të vështrimeve të OSBE-së lidhur me zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave.

Më pas raporti fokusohet në tri probleme bazuar në gjetjet e identifikuara nga monitoruesit e OSBE-së: së pari, ngritja e aktakuzave për trafikim kur elementet përbërëse të veprës së trafikimit nuk janë të pranishme; së dyti, dështimi për të ndjekur veprimtarinë shtesë penale të kryer gjatë rrjedhës së trafikimit; dhe së treti, shndërrimi i veprimit të trafikimit në një vepër më pak serioze se ajo e trafikimit që rezulton në ndëshkime më të lehta për kryesit.

Raporti përfundon me rekomandime për gjyqtarë, prokurorë, dhe institucionet e Kosovës që të përmirësojnë ndjekjen penale të trafikimit dhe identifikimin e viktimave.

### **3. PËRKUFIZIMI I TRAFIKIMIT DHE ZBATIMI I LIGJIT PËRMBI FAKTE**

#### **3.1 Definicioni i Trafikimit**

Protokolli i Palermos<sup>5</sup> përfshin definicionin kryesor të njohur ndërkombëtarisht për trafikim. Kodi Penal i Kosovës<sup>6</sup> (KPK) përkufizon trafikimin duke përdorur

---

disponueshme vetëm në gjuhën angleze në <http://www.osce.org/files/documents/2/0/36159.pdf> (e qasur me 10 gusht 2011); Libri nga zyra e OSBE-së së Përfaqësuesit Special dhe Koordinatorit për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, *Analizë e Modelit të Biznesit të Trafikimit me Qenie Njerëzore për të Parandaluar më Mirë Krimin* (maj 2001), e disponueshme vetëm në gjuhën angleze në <http://www.osce.org/files/documents/c/f/69028.pdf> (e qasur me 10 gusht 2011); Raporti Vjetor për vitin 2010 i Përfaqësuesit Special dhe Koordinatorit për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, *Luftimi i Trafikimit si Skllavëri e kohës Moderne: Çështje e të Drejtave, Lirive dhe Sigurisë*, e disponueshme vetëm në gjuhën angleze në <http://www.osce.org/cthb/74730> (e qasur me 10 gusht 2011); dhe *TIP 2010*, i Departamentit të Shtetit të ShBA-ve, ibid.

<sup>4</sup> Raport i OSBE-së, *Analiza ligjore e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë*, ibid.

<sup>5</sup> Protokolli për Parandalimin, Zhdukjen dhe Dënimin e Trafikimit me Njerëz, Veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën kundër Krimit të Organizuar Transnacional, UN Doc. A/55/383 (15 dhjetor 2000), hyri në fuqi me 25 dhjetor 2003.

<sup>6</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 6 nëntor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-

të njëjtën gjuhë si Protokollin e Palermos.<sup>7</sup> KPK-ja dënon veprën penale të trafikimit të të rriturve me dënim prej 2-12 vjet burg.<sup>8</sup> Trafikimi i një fëmije, i përcaktuar si një person nën moshën 18 vjeçe,<sup>9</sup> mbart një dënim prej 3-15 vjet burg.<sup>10</sup>

Duke përdorur të njëjtat fjalë që gjinden në Nenin 3 të Protokollit të Palermos, neni 139 (8) (1) i KPK-së përkufizon trafikimin si:

“[R]ekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.”

Përkufizimi i trafikimit është i ndërlikuar, por bëhet i qartë nëse zbërthehet në tri elementet e veta: *vepra, mjetet e paligjshme dhe për qëllim të shfrytëzimit*.

1. *Vepra*: Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pranimi i personave.
2. *Mjetet e paligjshme*: kërcënimi ose përdorimi i dhunës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit të keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës apo të një pozite të ndjeshme apo me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që të ketë kontroll mbi personin tjetër.
3. *Për qëllim të shfrytëzimit*: Fjala shfrytëzim përkufizohet ajo që “përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.”<sup>11</sup>

OSBE ka gjetur se praktikuesit e ligjit në Kosovë shpesh nuk zbatojnë në mënyrë të duhur këto elemente të veprës së trafikimit.

Siç është përmendur më sipër të gjithë tre elementet janë të nevojshme për të dënuar dikë për trafikim të një viktime të rritur, por elementet ligjore të domosdoshme për dënim paksa ndryshojnë kur viktima është fëmijë. Kur një fëmijë është viktimë e trafikimit atëherë vetëm elementi i veprës dhe ai i

---

002 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës Nr 2003/25, që la ligjin përmbajtësish të njëjtë me ligjin e vitit 2003, me vetëm një pjesë të shtuar për aranzhimet lidhur me deklaratimet për fajësi dhe ndryshimin e emrit të ligjit në Kodi Penal i Kosovës, prej këtu e tutje KPK.

<sup>7</sup> Trafikimi po ashtu është i ndaluar me kushtetutën e Kosovës.

<sup>8</sup> Shih Nenin 139(1) të KPK-së.

<sup>9</sup> Shih Nenin 107(21) të KPK-së.

<sup>10</sup> Shih Nenin 139(2) të KPK-së.

<sup>11</sup> Shih Nenin 139(8)(2) të KPK-së.

shfrytëzimit nevojiten për dënim.<sup>12</sup> Pasi që nga fëmija nuk mund të pritët që të pajtohet me çfarëdo veprë që bëhet me qëllim të shfrytëzimit, elementi “mjetet e paligjshme” nuk konsiderohet si elementi i domosdoshëm i veprës penale.<sup>13</sup> Duke kryer cilëndo veprë (rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo pranimin e personave) për qëllim të shfrytëzimit është trafikimi kur viktimë është një fëmijë.

Në qoftë se për disa përkufizimi mbetet i rëndë, edhe pas zbërthimit të definicionit në tri elementet e veta, një praktikues i ligjit mund të përzgjedh një pjesë të secilit element si mënyrë për t’ju qasur analizës së një rasti të dyshuar të trafikimit.

Për shembull, nëse një hetim tregon se një i pandehur rekrutoi një viktimë të rritur përmes mashtrimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, me qëllim të shfrytëzimit seksual, tri elementet e kërkuara për veprën penale mund të përmbledhen si në vijim:

- 1) I pandehuri kreu veprën e rekrutimit;
- 2) I pandehuri rekrutoi përmes mjeteve të paligjshme, duke përdorur mashtrimin dhe keqpërdorimin e pushtetit;
- 3) Qëllimi i të pandehurit ishte që ta shfrytëzojë seksualisht viktimën.

Por analiza në tri-hapa nuk është kaq e thjeshtë. Sqarimi i rezultatit të një hetimi është e pakompletuar pa e shtjelluar prokurori më tej sqarimin duke i përfshirë faktet e zbuluara gjatë hetimit. Këto fakte duhet të shpjegohen qartazi dhe të vërtetohen me dëshmitë e mbledhura, përndryshe tri elementet e kërkuara të dhëna më sipër mbesin pohime të pa-përkrahura. Është e domosdoshme që të përfshihen dëshmitë (pohimet e bazuara në fakte) për të përkrahur secilin nga tri elementet e sipërme.

### 3.2 Vendimi që zbaton ligjin përmbi fakte

Një shembull i praktikës më të mirë sa i përket vendimit gjyqësor që në mënyrë adekuate e zbaton ligjin përmbi fakte është ai i një vendimi të shpallur verbalisht nga gjykata së qarkut në Pejë/Peć, i datës 6 prill 2011.<sup>14</sup> Kolegji i gjykimit përbëhej prej dy gjyqtarëve ndërkombëtar të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe një gjyqtari vendor

[Vepra] Në janar të vitit 2007, rekrutoi palën e dëmtuar duke i paguar asaj shpenzimet e udhëtimit nga Moldavia për Kosovë.

[Mjetet e paligjshme] Ajo ishte mashtruar nga i pandehuri që të besojë se po vinte në Kosovë që të punojë si kameriere.

[Mjetet e paligjshme] Pala e dëmtuar ishte në pozitë të ndjeshme ekonomike dhe e varur nga i pandehuri. Ai i pagoi asaj shpenzimet e udhëtimit dhe nga ajo kërkohej që t’i kthej ato shpenzime nga fitimet e

<sup>12</sup> Shih Nenin 139(8)(4) të KPK-së.

<sup>13</sup> Shih Nenin 139(8)(3) të KPK-së.

<sup>14</sup> Numri i Rastit P.No. 445/09, Pitaqaj *et al*, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/CM-District-Court-of-Peja.php> (e qasur me 10 gusht 2011).

saj. Ato fitime përfshinin *paratë që ajo fitonte duku i ofruar shërbime seksuale klientëve.*

[*Mjetet e paligjshme*] I pandehuri ishte në *pozitë të pushtetshme krahasuar me palën e dëmtuar, dhe ai keqpërdori atë pushtet që ta shfrytëzojë atë për t' i ofruar shërbime seksuale klientëve.*

[*Për qëllime të shfrytëzimit*] *Pas arritjes* ajo ishte detyruar nga i pandehuri që t' i ofrojë *shërbime seksuale klientëve.*

Aktgjykimi me shkrim në rastin e mësipërm më pas shpjegoi, në një vendim mirë të shkruar, cilat fakte prej gjykimit ishin të lidhura me secilin prej tri elementeve në definicionin e trafikimit.

#### **4. TRE SHEMBUJ TË ZBATIMIT JO-ADEKUAT TË LIGJIT PËRMBI FAKTE**

##### **4.1 Aktakuzë për trafikim kur vepra e trafikimit nuk është e pranishme**

OSBE ka vërejtur se dëshmitë e marra gjatë një hetimi ndonjëherë nuk lidhen me ligjin e aplikueshëm kur prokurori akuzon të pandehurin.

Për shembull:

Të pandehurit u morën vesh që t' i dërgojnë një burrë e një grua në Itali në këmbim për 3,000 Euro. E ëma e viktimës mashkull i dha paratë duke menduar se paratë do të ndihmojnë që djali dhe nusja e saj të shkojnë në Itali. Grupi filloi udhëtimin (me veturë) për në Itali, në dhjetor të vitit 2005. Edhe pse viktimat paguan 2,000 Euro shtesë ata nuk u transportuan për në Itali. Udhëtimi përfundoi në Kroaci.

Në gusht të vitit 2010, një gjyqtar nga gjykata e qarkut në Gjilan/Gnjilane konfirmoi aktakuzën për trafikim, bazuar në faktet e mësipërme.<sup>15</sup>

“...pas analizimit të aktakuzës dhe provave të gjetura në shkresat e lëndës, [gjyqtari] gjeti se ka fakte të mjaftueshme që tregojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë.”

Gjyqtari dështoi të vlerësojë se a e përkrahin dëshmitë aktakuzën për trafikim, apo keqkuptoi se si t' i krahasojë dëshmitë (d.m.th faktet) me ligjin përkatës. Pasi që të gjitha elementet e veprës penale nuk janë të pranishme, OSBE nuk konsideron se kjo përbënte vepër penale të trafikimit. Elementi i *veprës* i transportimit është i pranishëm, mirëpo nuk ka dëshmi për të përkrahur elementet e mjeteve të paligjshme apo shfrytëzimit nga vepra penale për të mbështetur një aktakuzë të trafikimit. Kontrabandimi me imigrantë, ndërkaq, është një vepër penale që nuk duhet të përmbajë çfarëdo mjeti të paligjshëm apo shfrytëzim. Kontrabandimi me

<sup>15</sup> Të dy të pandehurit ishin arrestuar dhe akuzuar për trafikim në vitin 2006. Aktakuza për njërin të pandehur ishte konfirmuar në dhjetor të viti 2006, pro për tjetrin jo deri në gusht të viti 2010. Data e gjykimit nuk është caktuar ende.

imigrantë është një marrëveshje për ta transportuar dikë në mënyrë joligjore përtej kufijve, çfarë duket të përshkruaj rasti më lartë. Megjithatë, nuk ka pasur ndonjë indikacion që mund të tregoj se gjykata ka marrë parasysh veprën e kontrabandimit me imigrantë të jetë aktakuzë më e përshtatshme.<sup>16</sup>

#### **4.2 Dështimi për të ndjekur penalisht për veprimtari shtesë penale**

Trafikantët shpesh kryejnë krime shtesë gjatë rrjedhës së veprimtarisë trafikuese. OSBE është e shqetësuar se trafikantët shpesh nuk akuzohen për këto vepra penale shtesë.

Me 1 prill 2011, një vendim i gjykatës së qarkut gjykoi mbi fakte që përfshinin:

- Dy fëmijë të mbyllur në bodrum;
- Klientë që u sillnin në këtë bodrum për të marr shërbime seksuale;
- Rrahja e dy fëmijëve për refuzim që të japin shërbime seksuale;
- Dëshmi të frikësimit, që përfshinte porosi të shkruara telefonike për shokët me kërcënime siç është, “Kam një vajzë që dëshirojë ta frikësoj, i kam thënë që e njoh një person që mund të të zhduk”;
- I pandehuri dhe meshkujt tjerë që sillleshin në bodrum duke kryer me fëmijët marrëdhënie seksuale me dhunë.

I pandehuri që kreu veprat e mësipërme ishte akuzuar për trafikim, mirëpo ky rast sugjeron nevojën për të hetuar dhe ndjekur një mori veprash tjera të cilat mund të jenë kryer bazuar në faktet e gjetura, përfshirë dhunim të vazhdueshëm, shkaktim të dëmit trupor, kërcënime, privim të paligjshëm nga liria, torturë dhe lehtësim të prostitucionit. Veç kësaj, nuk ka pasur hetime apo aktakuzë për klientët të cilët shkonin në bodrum për të marrë shërbime seksuale nga fëmijët.

Është akuzuar vetëm një tjetër person në këtë rast, pronari i bodrumit. Ai pranoi se ka pasur marrëdhënie me një viktimë 13 apo 14 vjeçare, dhe është akuzuar për abuzim seksual me personin nën moshën 16 vjeçare.<sup>17</sup> Ai nuk u akuzua për trafikim, edhe pse dukej se e kishte strehuar të miturën për qëllim shfrytëzimi.

#### **4.3 Shndrimi i trafikimit në një vepër më pak serioze se trafikimi**

Në korrik të vitit 2009, një gjykatë e qarkut i dënoi dy të pandehur për vepër të tentim-trafikimit, në vend se për trafikim. Njëri i pandehur mori dënim me dhjetë

---

<sup>16</sup> Shih Nenin 138(7) (1) të KPK-së. “Shprehja ”kontrabandim me migrantët” do të thotë prokurim me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore a financiare i një hyrjeje të paligjshme të personit në Kosovë, i cili nuk është banor i Kosovës ose në shtetin në të cilin personi nuk është banor i përhershëm apo shtetas i huaj”

<sup>17</sup> Neni 138(7) (1) të KPK-së kufizon mundësinë për “pëlqim” për akt seksual vetëm për ata që kanë arritur moshën 16 vjeçe. KPK ka një nen mbi dhunimin (Neni 193) dhe një nen për abuzim seksual të personave nën moshën 16 vjeçe (Neni 198). OSBE ka vërejtur se të pandehurit e dyshuar për marrëdhënie seksuale me fëmijë nën moshën 16 vjeçe në përgjithësi nuk akuzohen me dhunim po që se nuk ka dëshmi dhune, por në vend të kësaj akuzohen me vepër më pak serioze të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeçe. Mungesa e qartësisë në këtë fushë të KPK-së, kombinuar me atë se si kodi interpretohet në praktikë është shqetësuese.

muaj burg, ndërsa tjetri me pesë muaj. Më poshtë është një përmbledhje e aktgjykimit:

Pasi që u arrit marrëveshja ndërmjet të pandehurit dhe një personi nga Shqipëria i cili kishte kontroll mbi të miturën, viktimën i u shit të pandehurit për 300 Euro. Pasi që i pandehuri morri kontrollin mbi të miturën, ai i tha asaj që do të punojë në Kosovë si valltare për pagesë ditore prej 10 Euro, edhe pse ajo nuk ishte valltare profesioniste. Ai dinte se e mitura ishte në një pozitë të ndjeshme, pa strehë dhe përkrahje familjare (ajo më herët ishte abuzuar nga një anëtar i familjes). Ai ishte në proces të transportimit të saj për në Kosovë, me qëllim të shfrytëzimit të saj në restorantin e tij kur u kap nga policia kufitare e Kosovës.

Andaj, ishte gjetur se i pandehuri kishte kryer veprën penale të tentim- trafikimit me qenie njerëzore.

Sa i përket kushtit për të dëshmuar *veprën, nevojitet vetëm një vepër* për të përmbushur elementin *vepër* brenda definicionit të trafikimit. Megjithatë në këtë rast janë kryer shumë vepra:

- *Rekrutimi:* Oferta për këtë fëmijë që të punojë në restorantin e tij;
- *Rekrutimi:* Kërkesa që i është bërë të rriturit tjetër për blerjen e kësaj fëmije;
- *Transferi:* Blerja e fëmijës për 300 Euro është bartje e kontrollit përmbi fëmijën;
- *Pranimi:* Momenti kur i pandehuri pranoi fëmijën nga personi tjetër;
- *Transportimi:* Momenti kur filloi transportimi i fëmijës.

Të gjitha këto aktivitete përbëjnë *vepra* brenda definicionit ligjor të veprës penale të trafikimit. Për shkak se fjala “ose” është përdorur në definicionin e trafikimit, kryerja e cilësdo nga këto vepra – po që se bëhen me qëllim të shfrytëzimit të fëmijës – është trafikim.

Për shkak se ishin përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit, është vështirë të dihet se pse i pandehuri nuk është dënuar për trafikim. Edhe pse policia e Kosovës e mbrojti fëmijën nga dëmi i mëtutjeshëm ky arrestim nuk e shndërroi veprën në një vepër më të lehtë apo ndryshe të karakterizuar.

## 5. PËRFUNDIME

Dështimi i shpeshtë i praktikuesve ligjor për të zbatuar dispozitat e veprës penale të trafikimit në mënyrë të duhur dëmton aftësinë e gjykatave të Kosovës për t’iu përgjigjur veprës penale të trafikimit. Rezultati është mos-ndëshkimi më i madh për kryesit e veprave, vazhdim i pozitës së ndjeshme për viktimat dhe vazhdim i trafikimit në Kosovë, që përbën shqetësim të madh për të drejtat e njeriut.

Raporti analizon problemet e rëndomta në ndjekjen penale efektive të rasteve përfshirë: së pari, ngritja e aktakuzës për trafikim kur elementet e kërkuara për veprën e trafikimit nuk janë të pranishme: së dyti, dështimi për të ndjekur veprimtarinë shtesë penale të kryer gjatë rrjedhës së trafikimit: dhe së treti, dështimi për të akuzuar për trafikim kur të gjitha elementet e trafikimit janë të pranishme.

Udhëzuesit për shembujt dhe praktikatat më të mira që përmban ky raport mund t'i ndihmojnë praktikuesve të ligjit të mendojnë se si të ndjekin në mënyrë efektive veprën penale të trafikimit. Analizimi dhe zbatimi korrekt i legjislacionit përkatës do të rris gjasat e dënimit të trafikantëve, identifikimit të viktimave si dhe të zvogëlojë numrin e viktimave të ardhshme të trafikimit.

## **6. REKOMANDIME**

OSBE i ofron praktikuesve ligjor në Kosovë rekomandimet specifike në vijim.

### **Për Gjyqtarët:**

- Gjyqtarët duhet të krahasojnë dëshmitë në dispozicion me secilin element të definicionit të trafikimit kur shqyrtojnë aktakuzat për trafikim dhe marrin vendimet e tyre.

### **Për Prokurorët:**

- Prokurorët duhet të specifikojnë dëshmitë faktike të cilat mund të lidhen me secilin element të definicionit të trafikimit;
- Prokurorët duhet të zgjerojnë hetimet e tyre në të gjitha veprat potenciale që mund të jenë kryer gjatë rrjedhës së trafikimit – siç janë frikësimi dhe kërcënimet, sulmet fizike dhe seksuale, dhunimi, privimi i paligjshëm nga liria, tortura apo skllavëria – dhe të akuzojë kryesit e dyshuar atëherë kur ka dëshmi të mjaftueshme për veprimtari shtesë penale krahas trafikimit.

### **Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:**

- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë të ofrojë trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë mbi atë se si të zbatojnë definicionin e trafikimit në gjetjen e fakteve nga ana e gjykatës (dëshmitë faktike mbi atë së çfarë ka ndodhur);
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet t'i trajnojë praktikuesit e ligjit në lidhje me tri elementet e përfshira në definicionin e trafikimit, dhe të theksojnë rëndësinë e përdorimit të fjalës “ose” në definicion;
- Trajnime në veçanti duhet të theksojë dallimin ndërmjet trafikimit të një personi të rritur dhe trafikimit të një fëmije, si dhe nevojën për të hetuar dhe akuzuar krime shtesë që shpesh kryhen gjatë rrjedhës së trafikimit;
- Trajnimi duhet të nënvizojë nevojën për të ndjekur çdonjërin që është i përfshirë në veprën penale të trafikimit, përfshirë pronarët e hapësirave që strehojnë viktimat, individët tjerë që përfitojnë nga kjo veprimtari

kriminale dhe klientët që shfrytëzojnë shërbimet e viktimave të trafikuar, posaçërisht kur viktimat janë fëmijë.